

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITIËS - OPSTINA VITINA

26-05-2023

Nr. i organit Org broj	Numri/broj	Shtetja Prilog	Vlera Vendoset
02-035/02-	737		

---

**MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI**

---

**MARRËVESHJE E PËRBASIKËT**  
**MBI MENAXHIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E SISTEMIT TË UJËSJELLËSIT**  
**NË FSHATIN SADOVINË E JERLIVE DHE E QERKEZËVE**

E lidhur me datën: 17.05.2023 në Gjilan

**1. Komunës së Vitisë, e përfaqësuar nga z. Sokol Haliti - Kryetar**

**2. KRU "Hidromorava"-sha në Gjilan, e përfaqësuar nga z. Ymer Salihu- Kryeshef Ekzekutiv**

**Neni 1.**

**Qëllimi i lidhjes**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është vënia nën menaxhim dhe mirëmbajtje të KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, si kompani e licencuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), e shërbimeve të ujit në sistemin e rrjetit të ujësjetësit për banorët e f. Sadovinë e Jerlive dhe Qerkezëve, Komuna Viti.

**Neni 2.**

**Obligimi primar për Kompaninë**

K.R.U "Hidromorava"-sha në Gjilan, pranon të marrë nën menaxhim sistemin e ujësjetësit si sistem të ndërtuar konform standardeve teknike të caktuara nga Autoriteti Rregullator për shërbime të ujit dhe ta mirëmbajë këtë rrjet në pajtim me standardet teknike për shërbimet e ujit.

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje do të jetë në periudhën gjashtë / 6 / mujore , duke filluar prej 01.06.2023 deri më 30.11.2023, me qëllim të kushtëzimit të investimeve që ka evidentuar komisioni i vlerësimit të gjendjes në teren e që është dakorduar kryetari i Komunës së Vitisë me stafin e tij.

**Neni 3.**

**Obligimi primar për banorët**

**3.1.** Banorët e f. Sadovine e Jerlive dhe Qerkezëve përmes kryetarit të bashkësisë lokale , marrin për obligim që t'u përmbahen kushteve për pagesën e shërbimeve të ujit të caktuar me urdhëresën për tarifën e shërbimeve të Autoritetit Rregullator për shërbimet e ujit për K.R.U. "Hidromorava"-SH.A. Gjilan.

**3.2.** Lartësia e arkëtimit të borxheve për shërbimet e ujit për çdo muaj vijues në këtë fshat duhet të jete konform shkallës së arkëtimit të caktuar në Planin e Biznesit i aprovuar nga Bordi i Drejtorëve dhe ARRU.

#### **Neni 4.**

##### **Obligimet e K.R.U. "Hidromorava"**

- 4.1. Të gjithë konsumatorët e f.Sadovinë e Jerlive dhe Qerkezëve i nënshtrohen procedurave në fuqi për kyqje të dala nga institucionet kompetente të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe Komunës së Vitisë.
- 4.2. Në rast të zgjerimit të rrjetit, të interesuarit i nënshtrohen procedurave aktuale që i rregullojnë këto çështje (ARRU dhe Komunës së Vitisë) në konsultim me Këshillin Lokal.
- 4.3. Të shfrytëzoj në mënyrë ekonomike dhe të siguroj mirëmbajtje të duhur të aseteve të këtij sistemi të ujësjetësimit sipas kushteve të licencës së punës së saj.
- 4.4. Përgjegjësia menaxhuese e K.R.U. "Hidromorava"-sha Gjilan, shtrihet deri te ujëmatësi për shpenzimet e ujit.
- 4.5. Të faturoj konsumatorët vetëm sipas faturave të ligjshme të aprovuara nga ARRU, apo formave tjera ligjore.
- 4.6. Të pranoj, t'i trajtoj në mënyrë të drejtë dhe me kohë ankesat e konsumatorëve t'i përgjigjet atyre, në rast të defekteve të reagojë në një kohëzgjatje prej 2-3 ditëve në pajtim me Kartën për Konsumatorë të aprovuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit.
- 4.7. Në rast të mos përmbushjes së shkallës së inkasimit sipas kësaj Marrëveshje, dhe mosriparimit të rrjedhjeve të brendshme nga ana e banorëve, K.R.U. "Hidromorava" do të aplikojë shkyqje individuale dhe kolektive konform Rregullave të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

#### **Neni 5.**

##### **Obligimet e banorëve**

- 5.1. Të lidhin kontrata individuale për shërbimet e ujit sipas formës dhe përmbajtjes e cila është aprovuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit.
- 5.2. Të vazhdojnë me pagesën e borxhit dhe pagesa të arrijë shkallën e përgjithshme të arkëtimit prej 90% , të borxhit të komunitetit për çdo muaj (duke mos i llogaritur rastet sociale).
- 5.3. Në afat prej 30 ditësh prej nënshkrimit të kësaj Marrëveshje të hartojë dhe dorëzojë listën e konsumatorëve.
- 5.4. Lista nga paragrafi 5.4. duhet të përmbajë: Emrin dhe Mbiemrin e konsumatorit, Numrin personal dhe Numrin e Ujëmatësit të kyçur në rrjetin e ujësjetësimit.
- 5.5. Pas kalimit të afatit nga paragrafi 4. i këtij neni, konsumatorët që duan të kyqen në rrjetin e ujësjetësimit do t'i nënshtrohen tarifave të Autoritetit Rregullator për Shërbime të ujit.

- 5.6. Të lehtësojë dhe lejojë qasjen gjatë orarit të punës dhe në ditë të tjera në raste emergjente K.R.U. "Hidromorava" në objektet –infrastrukturën e sistemit të ujësjiellësit me qëllim të instalimit, rehabilitimit, largimit, riparimit, mirëmbajtjes dhe inspektimit të të gjitha aseteve, që janë pjesë e rrjetit të sistemit.
- 5.7. Të respektojë paprekshmërinë e ujëmatësve, të përmbahet nga veprimet, për të cilat nuk është autorizuar paraprakisht nga që nuk është paraprakisht nga K.R.U. "Hidromorava".
- 5.8. Të respektojë dhe të mbrojë në çdo kohë integritetin dhe pozitën e mirë të aseteve të vendosur në objektin e tyre.
- 5.9. Që brenda një kohe sa më të shkurtër të riparojë rrjedhjet në gypsjiellësa dhe instalime të tjera që janë përgjegjësi e tyre (prej ujëmatësit e deri në instalimet e brendshme në shtëpi).
- 5.10. Të njoftojë menjëherë K.R.U. "Hidromorava" për ndonjë parregullsi ose fakt që mund të shkaktojë çrregullime në furnizim me ujë, apo që mund të shkaktojë dëmtimet e aseteve të rrjetit.
- 5.11. Për çdo kycje të re duhet të merret pëlqimi paraprak nga K.R.U. "Hidromorava", në të kundërtën kycja konsiderohet ilegale.
- 5.12. Të paraqesë me kohë lidhjen ilegale në rrjet para organeve kompetente të ndjekjes dhe t'i informojë për to palët në Marrëveshje.
- 5.13. Për çdo prishje eventuale të kycjeve individuale në rrjetin kryesor t'i marrë përgjegjësitë e riparimit dhe eliminimit në afat prej tre /3/ muajve, duke filluar nga dita e dorëzimit të sistemit të ujësjiellësit në menaxhim të K.R.U. "Hidromorava".
- 5.14. Këshilli Lokal ka obligim që t'i shlyej të gjitha faturat ndaj KEDS-it dhe të tjera të krijuara gjatë shfrytëzimit të sistemit deri në ditën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje mirëkuptimi.

#### **Neni 6.**

#### **Obligimet e Komunës së Vitisë**

Komuna e Vitisë obligohet:

- 6.1. Të mbikqyrë në vazhdimësi procesin e menaxhimit të sistemit të ujësjiellësit nga ana e K.R.U. "Hidromorava"
- 6.2. Të ushtroj autoritetin e saj në zbatimin e nenit 3. të kësaj Marrëveshje.
- 6.3. Të mbrojë asetet përkatëse nga keqpërdorimet e mundshme.
- 6.4. Te investoje sipas mundësive në gjetjen e donatorëve për zgjerimin e kapaciteteve të ujit dhe ndërtimin e sistemeve të reja.

**Neni 7.**

**Rregullat në rast kontesti**

Palët pajtohen që ligji i aplikueshëm në rast kontesti në mes palëve do të jenë ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës të cilat përcaktojnë dhe rregullojnë veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të ujësjetësimit.

**Neni 8.**

**Bartja e aseteve**

Komuna e Vitisë asetet e këtij sistemi mund t'ia bartë për menaxhim palës së tretë e cila fiton licencën e punës nga ana e Autoritetit për Shërbime të Ujit, në rast të humbjes së të drejtës për punë-Licencës së K.R.U. "Hidromorava"-SH.A.

**Neni 9.**

**Zotimet e palëve në Marrëveshje**

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje të mirëkuptimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për vendos do të jetë Gjykata kompetente.

**Neni 10**

**Numri i ekzemplarëve**

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit është e hartuar në katër /4/ ekzemplar identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

**Palët në Marrëveshje**

Kryetari i Kompanisë së Vitisë

( z. Sokol Mami )



KRU "Hidromorava" sh.a -Gjilan  
Kryeshafi Ekzekutiv

( z. Ymer Salihu )